



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 714/15 Prot.

Tiranë, më 17.05.2021

VENDIM

Nr. 89, datë 17.05.2021

PËR
MIRATIMIN E MË PAS NGRIRJEN E PROCEDURËS SË PËRCJELLJES SË
DOKUMENTACIONIT TË DR. QAMIL DIKA
PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR” PRANË KPPA

Mbështetur në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të RSH”, në VKM nr.112, datë 23.2.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, në VKM nr.27, datë 29.1.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, si dhe në Vendimin e Senatit Akademik të UST-së nr.42, datë 27.11.2020 “Për vijimin e procedurave të vlerësimit të aplikimeve për fitimin e titujve akademikë në Universitetin e Sporteve të Tiranës”; shkresës nr. 718 prot, dt. 14.05.2021 “Njoftim për dorëheqje të parevokueshme” të Dr. Qamil Dika, Senati Akademik i UST-së, në mbledhjen e tij të datës 14.5.2021, si dhe vazhdimin e po kësaj mbledhjeje në datën 17.05.2021

V E N D O S I:

1. Miratimin në pjesën e parë të mbledhjes së dt. 14.05.2021, për përcjelljen e dokumentacionit të Dr. Qamil Dika për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”, pranë Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së (KPPA).
2. Ngrirjen e procedurës, në vazhdimin e mbledhjes në datën 17.05.2021, të përcjelljes së dokumentacionit të Dr. Qamil Dika, për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar” pranë Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, deri në momentin e marrjes së një interpretimi ligjor shterues për vijimësinë e procedurës, pas dhënies së dorëheqjes së parevokueshme prej tij si personel akademik me kohë të plotë në UST.
3. Ky Vendim i bëhet me dije Njësisë Kryesore, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes si dhe Z. Qamil Dika.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AGRON KASA

